



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 469/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxha kryesues, Vllastimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Menaxherit të Qendrës së Votimit 1904E në shkollën fillore “Dardania” në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

### V E N D I M

**REUZOHET** si e pabazuara ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER).

### A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik FER, me të cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në shkollën fillore “Dardania” në Prishtinë, në Qendrën e Votimit (QV) nr. 1904E, ka pas parregullsi gjatë procesit të ngase menaxheri i kësaj qendre të votimit e ka lejuar të votoj një person edhe pse e kishte gishtin e spërkatur.

Parashtruesi i ankesës nuk ika bashkangjitur asnjë provë ankesës.

Në raportin e Policisë të datës 13.12.2010, me nr.SPJ-AS-1/0266/10, theksohet se nuk ka pas asnjë paraqitje të ndonjë rasti i cili ka të bëjë më qendrën e votimit të lartcekur. Në raportin e policisë potencohet se nuk ka pas asnjë ankesë nga asnjë person që është penguar për të ushtruar të drejtën e votës.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet e bëra nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi të për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga menaxheri i QV-së siç potencohet në ankesë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 469/2010 më datën 14.12.2010.

